



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.199 dt.15.12.1997

**PER
FINANCIMIN NGA ANA E BASHKISE PER BLERJEN E
MOTOCIKLETAVE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.15.12.1997, pasi shqyrtoi relacionet e paraqitura nga Drejtoria e Veterinarisë dhe Ushqimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit për financimin nga të ardhurat e Bashkisë dhe në mbështetje të nenit.14 të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” si dhe ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”

VENDOSI

1. Dhënien e fondit nga të ardhurat e Bashkisë për blerjen e katër motoçikletave për Inspektoriatin Veterinar dhe një për atë të Mjedisit me vlerën 800.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Veterinarisë dhe Ushqimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI